


Tregtia e jashtme e mallrave

Mars 2023

Tiranë, më 18 Prill 2023: Në Mars 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 42 mld lekë, duke u ulur me -11,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 9,8 %, në krahasim me Shkurt 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 81 mld lekë, duke u ulur me -3,7 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 15,9 %, në krahasim me Shkurt 2023. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 38 mld lekë, duke u rritur me 6,9 %, krahasuar me Mars 2022 dhe me 23,3 %, në krahasim me Shkurt 2023.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë tremujor eksportet e mallrave arritën vlerën 123 mld lekë, duke u rritur me 2,1 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 208 mld lekë, duke u rritur me 0,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 86 mld lekë, duke u ulur me 1,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Mars 2023, në uljen e eksporteve prej -11,7 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -8,6 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,8 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -0,6 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,6 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,8 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me +0,2 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Mars 2023




Eksportet, gjatë këtij tremujori janë rritur me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,5 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +1,5 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -3,1 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -0,8 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Mars 2023, në uljen e importeve prej -3,7 %, krahasuar me Mars 2022, kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,4 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me -1,5 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +3,0 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +2,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Mars 2023



Si tremujor, importet janë rritur me 0,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,1 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,7 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +0,2 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,1 pikë përqindje dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,9 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Mars 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Mars 2022 janë: Kosovë (2,0 %), Greqia (28,0 %) dhe Spanja (170,5 %). Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Italia (17,5 %), Gjermania (17.0 %) dhe Kroacia (22.1 %).

Gjatë këtij tremujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (2,5 %), Greqia (66,4 %) dhe Maqedonia (47,8 %). Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Italia (8,5 %), Gjermania (21.8 %) dhe Kina (49.0 %).

Në muajin Mars 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Kina (2,8 %), Gjermania (2,5 %) dhe Zvicra (335,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me Mars 2022 janë: Italia (1,5 %), Turqia (22,4 %) dhe Greqia (25,5 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (28,3 %), Gjermania (7,8 %) dhe SHBA (55,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (3,7 %), Turqia (11,2 %) dhe Greqia (19,0 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Mars 2023



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 59,1 %, të gjithë tregtisë. Në Mars 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,2 %), Turqia (7,5 %), Gjermania (6,4 %) dhe Greqia (6,2 %).

Shkëmbimet tregtare, për tremujorin e parë 2023, me vendet e BE-së zënë 59,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Mars 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,5 %), Turqia (7,4 %), Kina (6,8 %) dhe Greqia (6,8 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Mars 2023

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	Janar– Mars 20	66	-8,9	138	-6,7	-72	47,7
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	Janar – Mars 21	80	21,9	162	17,5	-82	49,5
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	Janar– Mars 22	120	49,6	207	27,9	-87	57,9
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	Janar– Mars 23	123	2,1	208	0,4	-86	58,9

Tab.2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Mars 2023

	Eksporte				Importe			
	Mars 2022	Mars 2023	Jan, - Mars 2022	Jan, - Mars 2023	Mars 2022	Mars 2023	Jan, - Mars 2022	Jan, - Mars 2023
Vendet e BE-së	33.882	31.716	87.287	90.168	43.909	40.731	110.275	105.980
Austri	296	418	993	1.174	468	751	1.533	1.720
Gjermani	2.774	2.301	9.659	7.548	5.360	5.493	13.344	14.391
Greqi	1.979	2.533	5.670	9.438	6.773	5.047	16.041	12.990
Itali	21.928	18.082	55.902	51.169	17.943	17.667	48.042	46.260
Spanjë	898	2.430	1.838	5.657	1.477	1.180	3.430	3.127
Kroaci	1.023	797	2.048	1.811	828	561	1.651	1.547
Të tjera të BE-së	4.983	5.154	11.176	13.369	11.059	10.031	26.234	25.945
Mbretëri e Bashkuar	121	110	323	436	588	668	1.605	2.003
Kinë	1.963	610	3.769	1.924	6.606	6.792	16.072	20.627
Kosovë	3.844	3.922	9.965	10.214	1.522	870	3.479	2.682
Maqedonia e Veriut	1.228	1.322	4.909	7.254	1.795	1.428	3.663	3.375
Rusi	-	-	2	3	972	774	3.223	1.716
SHBA	2.809	357	3.623	1.263	1.038	1.690	2.740	4.257
Turqi	552	481	1.187	1.377	11.256	8.729	26.043	23.135
Ukrainë	97	94	177	435	115	177	1.373	714
Zvicër	412	485	1.035	2.096	641	2.788	2.055	3.993
Të tjera	2.806	3.013	7.736	7.356	15.189	15.872	36.815	39.714
Gjithsej	47.715	42.111	120.012	122.526	83.631	80.517	207.343	208.197

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Mars 2023

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Mars 2022	Mars 2023	Jan, - Mars 2022	Jan, - Mars 2023	Mars 2022	Mars 2023	Jan, - Mars 2022	Jan, - Mars 2023
Gjithsej	47.715	42.111	120.012	122.526	83.631	80.517	207.343	208.197
Ushqime, pije, duhan	4.170	4.927	10.484	12.241	13.056	11.773	33.070	31.734
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	11.376	9.066	30.406	31.896	13.796	10.080	31.871	25.452
Produkte kimike dhe plastike	1.864	1.588	4.654	3.733	10.751	12.490	26.078	29.539
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	286	251	759	820	1.630	1.437	4.159	3.697
Prodhime druri dhe letre	1.160	1.132	3.143	3.117	2.992	2.787	7.708	7.154
Tekstile dhe këpucë	11.732	11.841	32.435	34.291	8.878	8.864	22.810	23.265
Materiale ndërtimi dhe metale	12.509	8.390	26.566	22.888	14.441	12.466	34.884	31.042
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	3.358	3.764	8.706	10.639	15.116	17.589	39.447	47.925
Të tjera	1.259	1.153	2.858	2.900	2.970	3.032	7.316	8.389

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Mars 2023

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Gjithsej	55.902	51.169	9.965	10.214	5.670	9.438	9.659	7.548
Ushqim, pije duhan	2.796	3.555	1.134	1.247	924	1.162	462	528
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	9.536	2.706	2.053	2.358	930	4.295	5.807	3.541
Produkte kimike dhe plastike	1.072	1.516	1.237	1.002	238	268	10	10
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	715	789	3	3	4	9	1	2.3
Prodhime druri dhe letre	1.825	1.881	383	274	485	471	74	34
Tekstile dhe këpucë	25.265	26.754	50	52	1.469	1.830	2.048	2.381
Materiale ndërtimi dhe metale	8.569	7.124	4.413	4.502	1.427	1.133	515	396
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	4.671	5.418	387	407	31	27	597	555
Të tjera	1.454	1.427	306	368	162	243	143	102

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Mars 2023

	Itali		Turqi		Kinë		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Gjithsej	48.042	46.260	26.043	23.135	16.072	20.627	13.344	14.391
Ushqim, pije duhan	6.323	6.096	1.488	1.606	345	415	1.414	1.433
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.288	1.243	1.365	4.216	1	10	293	218
Produkte kimike dhe plastike	5.546	5.620	2.619	3.298	1.684	1.914	3.173	2.868
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	3.387	2.975	125	92	172	186	24	21
Prodhime druri dhe letre	1.701	1.681	1.162	1.320	226	359	275	183
Tekstile dhe këpucë	11.451	11.120	4.218	3.564	2.531	2.878	580	617
Materiale ndërtimi dhe metale	6.190	6.345	11.521	5.098	1.887	2.822	424	516
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	9.471	9.318	2.389	2.865	7.709	10.475	6.763	7.952
Të tjera	1.686	1.863	1.155	1.075	1.517	1.567	397	583

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri